

PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

KOMUNA E KËRÇOVËS

MAJ, 2019

Përmbajtja

Shkurtesat.....	3
Hyrje	4
Metodologjia dhe qasja	5
Fushat me prioritet për intervenim përmes identifikimit të shkaqeve rrënjësore të ekstremizmit të dhunshëm në komunën e Kërçovës.	8
Analiza e pemës së problemit (Komuna e Kërçovës)	9
Analiza e pemës së zgjidhjes (Komuna e Kërçovës)	10
Plani Lokal i Veprimit	13

Shkurtesat

PEDh Parandalimi i Ekstremizmit të Dhunshëm

KKPEDhLKT Komiteti Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftë Kundër Terrorizmit

EVK Ekipi Veprues në Komunitetit

QBP Qendra për Bazë të Përbashkët

PLV Plani Lokal i Veprimit

QPS Qendra për Punë Sociale

OJQ Organizatat Joqeveritare

QRK Qendra Rinore dhe e Komunitetit

KR Këshilli Rinor

Hyrje

Republika e Maqedonisë së Veriut, si cilido vend tjetër në bashkësinë ndërkombëtare, nuk është immune ndaj kërcënimeve të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Kohëve të fundit, kërcënimi global ka kërkuar që Republika e Maqedonisë së Veriut të rishqyrtojë në veçanti marrëdhëniet e saj me vendet fqinje, bashkësinë ndërkombëtare dhe palët e interesit kombëtarë, sa i takon parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Rritja e tensioneve ndërkombëtare, të cilat përkuan me ndarjen regjionale të shteteve në Ballkan, të nxitura nga depërtimi i mbështetjes së huaj financiare, ka inkurajuar komunitetet që të bëhen më radikale dhe ekstreme. Sipas informacioneve të mbledhura në vitin 2016, 110 luftëtarë nga Republika e Maqedonisë së Veriut shkuan në Siri, prej të cilëve 25 u vranë atje dhe 86 u kthyen në vend.¹

Bashkësitë lokale janë parashikuar si një nga partnerët kyç në fushën e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm. Plani i veprimit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm thekson rolin e aktorëve lokalë, duke përfshirë organet e qeverisjes komunale dhe shoqërinë civile, në zbatimin e programeve efektive të parandalimit. Kjo strategji, në mënyrë të veçantë, thekson rolin e bashkësisë dhe rekomandon miratimin e modeleve policore të orientuar ndaj bashkësive dhe programe që kanë për qëllim zgjidhjen e çështjeve në partneritet me bashkësinë dhe fuqimisht bazohen në të drejtat e njeriut me qëllim të evitimit të vënies në rrezik të anëtarëve të bashkësisë. Kjo do të rriste vetëdijen dhe vigjilencën e publikut dhe do të përmirësonte kuptimin dhe njohuritë e policisë lidhur me bashkësitë, duke rritur kështu aftësinë e tyre për të qenë pro-aktive dhe për të identifikuar pakënaqësitë dhe çështjet kritike në një fazë të hershme.² Në këtë drejtim, Strategjia Kombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut për Kundërvënien e Ekstremizmit të Dhunshëm (2018-2022) thekson rolin e bashkësive lokale dhe angazhimin e tyre në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Komiteti kombëtar për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftë kundër terrorizmit (KKPEDhLKT) përqendrohet në çështje të ndryshme në nivel të qeverisjes lokale, duke theksuar disa fusha ku autoritetet kombëtare dhe lokale duhet të bashkëpunojnë për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin, duke përfshirë:

- Përmirësimin e besimit dhe bashkëpunimit mes shërbimeve qeveritare të sigurisë dhe udhëheqësve fetarë;
- Saktësimin plotësues të trajnimit dhe përkrahjes gjithëpërfshirëse për bashkësitë fetare për t'iu kundërvënë radikalizmit në internet;
- Avancimin e trajnimit të bashkësive, familjeve, punonjësve të burgut dhe udhëheqësve fetarë me qëllim të identifikimit të shenjave të hershme të radikalizimit të dhunshëm;
- Zhvillimin e mjeteve dhe masave për kundërvënien e vëllimit të keqinformimit që potencon narrativë të polarizuar mes kategorive të cënueshme të qytetarëve ; dhe,

¹ Komiteti kombëtar për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftë kundër terrorizmit i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut "Strategjia kombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut për kundërvënien e ekstremizmin e dhunshëm (2018-2022)", 2018

²Strategjia globale për luftë kundër terrorizmit Kombeve të Bashkuara, plani i veprimit për parandalim të ekstremizmit të dhunshëm, 2015

- Zhvillimin e proceseve dhe procedurave për të inkurajuar programe të bashkësive që përkrahin kohezionin shoqëror i cili parandalon ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin.

Një iniciativë e rëndësishme për promovimin e qasjes me bashkësinë në qendër lidhur me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në Maqedoninë e Veriut është krijimi i Ekipeve Vepruese në Komunitet (EVK). Të iniciuara nga KKPEDhLKT, të përkrahura nga Qendra për Bazë të përbashkët, the komunitat pilote (Çairi, Kërçova dhe Gostivari) janë përzgjedhur dhe janë themeluar EVK-të në fillim të vitit 2019. Qëllimi i këtyre ekipeve është përkrahja e përpjekjeve parandaluese në nivel lokal me fokus në gjetjen e zgjidhjeve për problemet lokale dhe mbështetje dhe integrim i aktiviteteve parandaluese në veprimet në nivel lokal. Është e ditur që nxitësit e radikalizimit nuk janë vetëm personal dhe transnacional por gjithashtu janë të rrënjësor në kontekst lokal, prandaj përgjigja ndaj atyre nxitësve duhet të përmbajë gjithashtu edhe kontekstin lokal.

Përderisa ekziston një rol i qartë dhe jetik për qeveritë kombëtare në koordinimin dhe përkrahjen e aktiviteteve të parandalimit të hershëm, ekipet vepruese në komunitet në bashkëpunim të afërt me autoritetet komunale janë kritike për zbatimin e strategjive kombëtare dhe planeve të veprimit. Me identifikimin e shqetësimeve lokale, zgjidhjeve të mundshme dhe me ofrimin e hapave konkretë se si të adresohen të njëjtat përmes planit lokal të veprimit, EVK-të mund të ndihmojnë me reagim në faza të hershme sipas nevojave të identifikuara dhe shqetësimeve të bashkësive ndaj K/PEDh.

Metodologjia dhe qasja

Qendra për Bazë të Përbashkët (QBP), në partneritet me tre pilot komuna: Çair, Gostivar dhe Kërçovë dhe Komitetin kombëtar për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftë kundër terrorizmit (KKPEDhLKT) organizuan punëtori treditore “Përgatitja e planeve lokale të veprimit për kundërvënien të ekstremizmit të dhunshëm” më 23-25 prill 2019.³

Përfaqësuesit e tre pilot komunave (anëtarët e ekipeve vepruese në komunitete) u mbledhën bashkë për të trajtuar çështjet e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit në bashkësitë e tyre përmes analizës së situatës dhe duke ofruar zgjidhje lokale për problemet lokale në fushën e ekstremizmit të dhunshëm. Anëtarët e EVK-ve morën pjesë në punëtori dhe ofruan kontributin e tyre, përvoja të dorës së parë, sfida të bashkësisë dhe zgjidhje të mundshme për çështjet që paraqiten që kanë të bëjnë me ekstremizmin e dhunshëm, që rezultoi me hapa dhe aktivitete konkrete të përfshirë në planin lokal të veprimit.

Fillimisht, në sesionin e parë, pjesëmarrësit bënë një analizë të situatës dhe diskutuan në përgjithësi shqetësimet e bashkësive të tyre për secilën komunë. Në veçanti, sesionet e grupeve u përqendruan në diskutimin dhe identifikimin e shkaqeve rrënjësore të ekstremizmit të dhunshëm në bashkësitë e tyre, në kuptimin më të mirë të shkaqeve dhe ndikimin e këtij fenomeni në bashkësitë e tyre, dhe zgjidhjet e mundshme nga

³Projekti është i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe Mbretëria e Holandës.


perspektiva lokale për tejkalimin e sfidave lidhur me temën, që janë shndërruar në veprime konkrete si pjesë e tre planeve lokale të veprimit për PEDh.

Analizimi i gjendjes në komunën e Kërçovës, përmes kontributit të ekipit veprues në komunitet, siguron bazë për planifikim të mirë që përfshinë reflektim mbi problemet me të cilat ballafaqohet bashkësia dhe identifikimin e veglave më të fuqishme për t'i zgjidhur ata.

Procesi i planifikimit ishte një përvojë mësimi në të cilën anëtarët e EVK-së nga komuna e Kërçovës arritën të analizonin dhe të kuptonin problemet e bashkësisë që kishin ndikim mbi ekstremizmin dhe radikalizimin si dhe u zotuan të punojnë drejt një vizioni të përbashkët për ta parandaluar ata.

Përfshirja e EVK-ve në procesin e planifikimit do të sigurojë që PLV të jetë realist, i bazuar mbi mjete dhe prioritetet në dispozicion dhe do të ndihmojë që lehtësisht të identifikohet roli që luan secili partner kur të ndërmerret ndonjë veprim.

Njohja dhe kuptimi i problemeve si dhe identifikimi i zgjidhjeve të tyre shërben si një pikënisje për veprim. Analiza e situatës, e cila është e ndikuar nga çështjet që kanë të bëjnë me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin, në vetvete përmban një sërë shkaqesh dhe pasojash të ndërlidhura. Analiza e situatës ishte baza për përmbledhje të problemeve me të cilat përballet bashkësia në Kërçovë, ose shkaqeve dhe pasojave të problemeve me fokus në ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin, dhe mandej të përdoret kjo analizë si bazë për krijimin e përgjigjes pozitive ndaj kësaj situatë, që u përkthye në hapa konkret në planin lokal të veprimit për komunën e Kërçovës.



Fushat me prioritet për intervenim përmes identifikimit të shkaqeve rrënjësore të ekstremizmit të dhunshëm në komunën e Kërçovës.

Ka një marrëveshje të përbashkët se nuk ka ndonjë **nxitës të vetëm** apo faktorqë ka ndikim në praninë dhe rritjen e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit. Prandaj, ekziston një numër nxitësish, pra: nxitës socio-ekonomikë, politikë dhe kulturorë/fetarë të cilët gjithashtu janë identifikuar si shqetësime të bashkësisë nga EVK-ja e komunës së Kërçovës dhe konsiderohen si faktorë themelorë të pranisë së ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit në bashkësinë e tyre, siç janë:

Faktorët socio-ekonomikë – Nxitësit socio-ekonomikë kanë të bëjnë me perceptimet e përjashtimit dhe marginalizimit social, dinamikat e rrjeteve dhe grupeve sociale, diskriminimi social, pritjet e frustruara dhe nevojat shoqërore dhe ekonomike të paplotësuara (të ngritura në veçanti nga EVK-ja nga Kërçova: kaosi social, pasiguria, migrimi i të rinjve, mungesa e punësimit fitimprurës veçanërisht për të rinjtë nga zonat rurale, mungesa e mundësive sipërmarrëse në bujqësi dhe në aktivitete të ngjashme ekonomike rurale, mungesa e mundësive për zhvillim personal dhe frika nga e ardhmja);

Faktorët arsimorë -nxitësit arsimorë dhe politikë përfshijnë polarizimin politik, korrupsionin dhe mosndëshkimin, qeverisjen e keqe (të ngritura në veçanti nga EVK-ja nga Kërçova: kapaciteti i dobët arsimor, pasiguria, nivel i ulët i edukatës familjare, trajtim joadekuat i personave në nevojë, delikuenca e të rinjve dhe abuzimi me substanca nga të rinjtë, nivel i ulët i vetëdijes mbi çështje problematike (dukuri negative si abuzimi me drogë nga të rinjtë);

Faktorë të rrezikut individual - aspektet psikologjike dhe emocionale, prania e gjuhës së urrejtjes, standardet sociale, edukimi jo-cilësor i individëve; ndikimi shoqëror dhe i mediave (propaganda në media dhe rrjete sociale).

Shkaqet kryesore, pasojat, zgjidhjet e mundshme dhe rezultatet e diskutuara dhe analizuara nga EVK-ja e komunës së Kërçovës formojnë një bazë për zhvillimin e aktiviteteve specifike të planit lokal të veprimtari dhe janë paraqitur më poshtë:

Analiza e pemës së problemit (Komuna e Kërçovës)

Mungesa e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve, delikuenca e të rinjve, rritje e numrit të pasojave negative mbi shëndetin e të rinjve

Humbja e shpresës për të ardhmen, rini dhe komunitet pasiv, veprime me ndikim për angazhimin në mjediset të rrezikut potencial

Mungesa e perceptimit të rrezikut nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm; sjellje asociale; orientim drejt grupeve/drejtimeve të gabuara

Migrimi i të rinjve, gjuha e urrejtjes, rritja e problemeve shëndetësore, vjedhje dhe aktivitete tjera kriminale

Çështje problematike – Fushat me prioritet për intervenim për K/PEDh

Faktorët socio-ekonomikë; faktorët arsimorë; faktorë të rrezikut individual

Varfëria dhe papunësia, përjashtimi social, gjendja psikologjike e një individi, jeta shoqërore dhe standarti

Sistemi i dobët arsimor, siguria publike, mbrojtja shëndetësore, frika nga e ardhmja, mungesa e vetëkontrollit

Mungesa e vetëkontrollit nga të rinjtë dhe mungesa e kontrollit të prindërve ndaj fëmijëve të tyre

Konflikte familjare; varfëri dhe nivel i ulët i arsimimit, mungesë e vlerave familjare

Rrjetet sociale dhe media; keqpërdorimi i lirisë së fjalës

Shkaqet	Pasojat

Analiza e pemës së zgjidhjes (Komuna e Kërçovës)

Shkëputje e të rinjve nga sjellja e dhunshme, abuzimi me substanca dhe delikuenca, risocializim

Qeverisje e mirë dhe politika; reformë në drejtësi sociale dhe polici; rritjen e besimit dhe bashkëpunimit mes policisë dhe bashkësisë

Rritje e fondeve për shërbime shëndetësore

Shkolla më të sigurta dhe sistemi cilësor arsimor

Fushat me prioritet për intervenim për K/PEDh

Vizioni: Individë më të sigurt, më të shëndetshëm dhe më të arsimuar në një shoqëri më të shëndetshme, të lirë nga dhuna dhe shpërdorimi në Komunën e Kërçovës

Profilizim më i mirë i profesioneve në sektorin e arsimit, zhvillimi i sektorit privat dhe mundësitë e punësimit për të rinjtë; nxitje të angazhimit të të rinjve në sistemin arsimor

Reformim i politikave të sigurisë (patrullimi në lagje); përfshirje e bashkësive rurale

Rritje e shërbimeve psikoterapeutike; rritja e aktiviteteve me karakter shoqëror

Angazhim i grupeve të vogla të bashkësive në aktivitetet shoqërore, rritja e masave të kontrollit (sistemet e paralajmërimit të hershëm)

Zhvillim i programeve të risocializimit, organizimi i debateve publike dhe punësimit edukativ

Zgjidhjet	Rezultatet

Bazuar në analizën e hollësishme për çdo çështje problematike, PLV është zhvilluar që të adresojë nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit përmes veprimeve të lidhura drejtpërdrejt me fenomenin ose përmes masave parandaluese që adresojnë shkaqet rrënjësore të çështjes problematike.

Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit kërkon padyshim një qasje multidisiplinare dhe mirë të integruar, bazuar në konsultimin e vazhdueshëm me bashkësinë. Sigurisht, ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi si çështje problematike nuk duhet të trajtohen si fenomen i vetëm, por si fenomen që është shkaktuar nga shumë faktorë në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi. Rrjedhimisht, PLV duhet gjithashtu të trajtojë edhe këta faktorë.

Plani Lokal i Veprimit

<p>Çështje problematike – Fushat me prioritet për intervenim për K/PEDh Faktorët socio-ekonomikë; faktorët arsimorë; faktorë të rrezikut individual</p>						
<p>Vizioni: Individë më të sigurt, më të shëndetshëm dhe më të arsimuar në një shoqëri më të shëndetshme, të lirë nga dhuna dhe shpërdorimi në Komunën e Kërçovës</p>						
<p>Qëllimi 1: Krijimi i komuniteteve të shëndetshme dhe më të sigurta përmes aktiviteteve të bazuara në dëshmi, ndërtimit të besimit dhe gasjeve inovative policore për parandalimin e sjelljeve të dhunshme dhe ekstremiste dhe shpërdorimeve të substancave</p>						
Përshkrimi i aktivitetit	Korniza kohore 2019/2020	Institucionet përgjegjëse	Partnerët	Treguesit	Rezultatet	Lidhja me Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit
Vlerësim themelor mbi perceptimin e bashkësisë për shqetësimet lidhur me PEDh, dhe dukuri tjera në bashkësinë e tyre	Periodikisht	EVK-të Komuna e Kërçovës	Policia, OJQ-të lokale	Raport vlerësimi i përpiluar dhe i shpërndarë % e ndryshimeve të perceptuara nga bashkësitë lokale	Strategjia e ndërhyrjes së hershme lokale Identifikimi i trendeve në nivel bashkësie	
Organizimi i fokus grupeve me bashkësitë e marginalizuara për identifikimin e shqetësimeve dhe nevojave të tyre në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë me fokus në EDh	Në tre muaj	EVK-të Komuna e Kërçovës	OJQ-të lokale Këshilli rinor Kryqi i kuq	# i aktiviteteve të organizuara # i grupeve të marginalizuara të përfshira gjatë diskutimeve të fokus grupeve	Angazhimi aktiv i të rinjve Rritja e vetëdijes në institucione lidhur me nevojat dhe prioritetet e bashkësisë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë dhe EDh	

Shfrytëzim i grupevetëbashkësisë dhe individëve me ndikim dhe funksione specifike në bashkësitë e tyre për të mbështetur bashkësinë me qëllim të ngritjes së shqetësimeve të komunitetit, promovimit të tolerancës dhe dialogut dhe adresimin e shqetësimeve dhe ankesave të bashkësisë në institucionet relevante	Së paku dy herë në vit	EVK-të Komuna e Kërçovës	OJQ-të lokale Këshilli rinor Kryqi i kuq	# i grupeve dhe individëve të angazhuar në mënyrë aktive % e shqetësimeve të drejtuara te institucionet relevante	Rritja e besimit dhe bashkëpunimit mesbashkësisë dhe institucioneve	
Organizimi i programeve të përbashkëta si “Policia në Lagje” me policinë lokale, përfaqësuesit e fshatrave dhe bashkësitë për të rritur vetëdijene bashkësisë për krimet në lagje (ndihmë për bashkësinë që të kuptojë se çfarë përbën veprim të dyshimtë dhe si të paraqesin ndonjë veprim të tillë te policia lokale)	Në vazhdimësi	EVK-të Komuna e Kërçovës	OJQ-të lokale Këshilli rinor Policia lokale	# i rasteve të sjelljeve të dyshimta të raportuara në polici	Sistemi i paralajmërimit të hershëm i vendosur në nivel lokal.	
Organizimi i debateve me grupe fetare për të kultivuar besimin e ndërsjellë dhe për të promovuar dialogun	Së paku 2 aktivitete në vit	EVK-të Komuna e Kërçovës	OJQ-të Institucionet fetare	# i debateve të organizuara # i pjesëmarrjes aktive të bashkësive dhe grupeve fetare % e ndryshimit të besimit mes bashkësive	Besim i rritur mes bashkësive dhe grupeve fetare Pjesëmarrje e shpeshtë dhe aktive e grupeve fetare në promovimin e dialogut	
Organizimi i seminareve për të drejtat e njeriut, duke përfshirë të drejtat e gjuhës dhe të drejtat për arsim dhe kulturë	Së paku 2 aktivitete në vit	EVK-të Komuna e Kërçovës	OJQ-të lokale Këshilli rinor	# i seminareve të organizuara # i të rinjve	Angazhim aktiv i të rinjve në nivel lokal	

për të gjitha bashkësitë			Kryqi i kuq	pjesëmarrës aktiv në seminare % e uljes së rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut		
Organizimi i grupeve mbështetëse të bashkëmoshatarëve dhe punëtorive edukative për të rinjtë lidhur me ngritjen e vetëdijes për rreziqet e shpërdorimit të substancave	Së paku 2 aktivitete në vit	EVK-të Komuna e Kërçovës	OJQ-të lokale Këshilli rinor Kryqi i kuq Punonjësit social Shkollat	# i punëtorive dhe grupeve mbështetëse nga moshatarëve të organizuara % e nivelit të vetëdijes ndaj rreziqeve të shpërdorimit të substancave	Zvogëlimi i dukurisë negative dhe numrit të rasteve në nivel lokal	
Qëllimi 2: Përfshirja aktive e bashkësisë në krijimin e mundësive më të mira për fëmijët përmes programeve adekuate arsimore, ekonomike dhe shëndetësore dhe largimit nga dukuritë negative						
Përshkrimi i aktivitetit	Korniza kohore	Institucionet përgjegjëse	Partnerët	Treguesit	Rezultatet	
Organizim i takimeve mes EVK-ve dhe mësimeve, prindërve dhe nxënësve lidhur me bashkëpunimin e tyre të mundshëm në fushën e PEDh	Në vazhdimësi	EVK-të Komuna e Kërçovës	Shkollat, Prindërit, OJQ-të	# i takimeve të organizuar # i aktiviteteve të përbashkëta të ndërmarra	Bashkëpunim më i mirë mes mësimeve, prindërve, nxënësve dhe EVK-ve	
Mbështetje e aktiviteteve të nxënësve brenda shkollës (gara sportive, kulturore dhe shkencore) dhe përfshirje e grupeve të marginalizuara në aktivitetet shkollore	Së paku 2 në vit	EVK-të Komuna e Kërçovës	OJQ-të lokale Këshilli rinor Kryqi i kuq Shoqatat sportive dhe kulturore	% e grupeve të marginalizuara të përfshirë në aktivitete # i aktiviteteve të organizuara	Përfshirje sociale e rritur Motivim i rritur i nxënësve dhe bashkëpunim më i mirë mes nxënësve nga bashkësi dhe grupe të ndryshme	
Krijimi i bibliotekave të	Vitin e parë	EVK-të	OJQ-të lokale	# i bibliotekave	Rini e arsimuar më mirë	

hapura për të rinjtë		Komuna e Kërçovës	Donatorët	të krijuara % e rritjes së lexuesve	Angazhim aktiv i të rinjve në nivel lokal	
Zhvillimi i programeve të praktikës me sektorin privat për të ulur migrimin e të rinjve dhe ofrimin e mundësive për punësimin e të rinjve	Në vazhdimësi	EVK-të Komuna e Kërçovës	OJQ-të lokale Bizneset private lokale	# i programeve të zbatuar të praktikës % i të rinjve të angazhuar në sektorin privat	Aftësi të zhvilluara dhe rritje të mundësive të punësimit për të rinjtë Rritja e bashkëpunimit me sektorin privat	
Zhvillimi i programeve për ri-integrimin dhe risocializimin e të rinjve delinkuentë që merren me abuzimin e substancave	Në vazhdimësi	EVK-të Komuna e Kërçovës	OJQ-të lokale Këshilli rinor Punëtorët social	# i programeve të zhvilluara # i rasteve të trajtuara	Ri-integrimi dhe risocializimi i rinisë	
Rritja e mbështetjes psikologjike për të rinjtë në rrezik dhe anëtarët e tjerë të bashkësisë në nevojë (fokusimi në grupet e marginalizuara)	Në vazhdimësi	EVK-të Komuna e Kërçovës	OJQ-të lokale Këshilli rinor Punëtorët social/psikologët Shkollat	# i rasteve të që janë drejtuar për ndihmë # i rasteve të trajtuara dhe që kanë pranuar mbështetje psikologjike	Zvogëlimi i sjelljes së dhunshme dhe veprimeve të dhunshme në nivel lokal Rritja e sigurisë publike	

Qëllimi 3: Fuqizimi i partnerëve lokalë për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm përmes rritjes së partneritetit me grupet fetare, mediat lokale, OJQ-të lokale për promovimin e tolerancës, zvogëlimin e gjuhës së urrejtjes dhe sjelljen e dhunshme dhe ekstremiste dhe respektimin e të drejtave të njeriut

Përshkrimi i aktivitetit	Korniza kohore	Institucionet përgjegjëse	Partnerët	Treguesit	Rezultatet	
Krijim i një strategjie lokale të komunikimit për të promovuar tolerancën, përfshirjen dhe dialogun mes bashkësive	Një herë vit	EVK-të Komuna e Kërçovës	Mediat lokale (TV Gurra, TV Uskana, Nova Makedonija) OJQ-të lokale Këshilli rinor në komunën e	Strategjia lokale e komunikimit e krijuar	Zvogëlim i numrit të incidenteve Angazhim më i mirë i bashkësisë në promovimin e tolerancës dhe dialogut	

			Kërçovës Religious groups			
Organizim i edukimit dhe trajnimit joformal për të rinjtë dhe promovim i aktiviteteve rinore (siç janë: programe trajnimi për shkathtësi të transformimit të konflikteve; zgjidhje e konflikteve dhe mënyra e menaxhimit të tyre dhe programet e këshillimit me moshatarë)	Në vazhdimësi	EVK-të Komuna e Kërçovës	Mediat lokale (TV Gurra, TV Uskana, Nova Makedonija) OJQ-të lokale Këshilli rinor në komunën e Kërçovës	% e të rinjve të angazhuar në aktivitete # i aktiviteteve rinore të organizuara	Rritje e numrit të programeve edukative për të rinjtë Rritje e pjesëmarrjes aktive të të rinjve dhe përfshirjes sociale në nivel lokal	
Programet edukative me ekspertë lokalë për promovimin e dialogut ndërkulturor dhe tolerancës përmes të gjitha formave të të nxënimit (duke përdorur edhe aktivitetet në terren edhe platformat e mediave sociale)	Në vazhdimësi	EVK-të Komuna e Kërçovës	Mediat lokale (TV Gurra, TV Uskana, Nova Makedonija) OJQ-të lokale Këshilli rinor në komunën e Kërçovës Ekspertët lokalë	# i programeve edukative % e rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut	Zvogëlim i numrit të incidenteve Bashkësi më tolerante dhe më aktive	
Programe televizive specifike për rreziqet që vijnë nga përdorimi i papërshtatshëm i rrjetëzimit social dhe për sigurinë në internet në përgjithësi përmes organizimit të aktiviteteve për ditë me internet më të sigurt dhe iniciativave të bashkëmoshatarëve	Në vazhdimësi	EVK-të Komuna e Kërçovës	Mediat lokale (TV Gurra, TV Uskana, Nova Makedonija) OJQ-të lokale Këshilli rinor në komunën e Kërçovës Policia lokale	# i programeve të zhvilluara % e rritjes së përdorimit më të sigurt të internetit	Ndërgjegjësim i rritur në bashkësi për parandalimin e kërcënimeve në internet dhe angazhimin e të rinjve në aktivitete kriminale	
Bashkëpunim me mediat lokale për të promovuar përmbajtje pozitive dhe edukative për të rinjtë dhe për të trajtuar	Në vazhdimësi	EVK-të Komuna e Kërçovës	Mediat lokale (TV Gurra, TV Uskana, Nova Makedonija)	# i programeve në media % e njerëzve të	Parandalim i sjelljeve të ekstremizmit të dhunshëm te të rinjtë	

shqetësimet e të rinjve (me fokus të veçantë në sjelljen dhe ekstremizmin e dhunshëm)			OJQ-të lokale Këshilli rinor në komunën e Kërçovës Punëtorët socialë Shkollat	informuar	Rritje e vetëdijes së të rinjve lidhur me kërcënimet	
Qëllimi 4. Forcimi i shkathtësive dhe kapacitetit të Ekipeve vepruese të bashkësisë për të marrë pjesë aktive në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe formave të tjera të dhunës						
Përshkrimi i aktivitetit	Korniza kohore	Institucionet përgjegjëse	Partnerët	Treguesit	Rezultatet	
Organizimi i trajnimeve për EVK-të dhe anëtarë të tjerë të bashkësive (veçanërisht gra dhe vajza nga zonat rurale) për të kontribuar në mënyrë të sigurt në përpjekjet për PEDh duke u përshtatur me rrethanat lokale.	Çdo vit	EVK-të Komuna e Kërçovës	OJQ-të lokale KKPEDhLKT	# i trajnimeve të organizuara # i njerëzve të trajnuar	EVK kompetente dhe anëtarësi aktive për të adresuar çështje të PEDh në nivel lokal	
Organizimi i trajnimeve me EVK-të dhe udhëheqës fetarë për t'u angazhuar me të rinjtë dhe për të promovuar në mënyrë efektive një kulturë të paqes në bashkësinë e tyre (p.sh. trajnime mbi shkathtësitë e komunikimit, përfaqësimit (advokimit) dhe zgjidhjes së konflikteve)	Së paku dy herë në vit	EVK-të Komuna e Kërçovës	OJQ-të lokale (Qendra Rinore dhe e Komunitetit-Kërçovë) Këshilli rinor në komunën e Kërçovës	# i trajnimeve të organizuara % e të rinjve të përfshirë	Rritje e angazhimit të të rinjve Zvogëlim i dhunës dhe rasteve të konfliktit midis të rinjve në nivel lokal	
Forcimi i kapaciteteve të organizatave rinore për të ndihmuar në mënyrë aktive EVK-të në aktivitetet e tyre për krijimin e marrëdhënieve të shëndosha me familjet dhe bashkësitë e tyre.	Çdo vit	EVK-të Komuna e Kërçovës	OJQ-të lokale (Qendra Rinore dhe e Komunitetit-Kërçovë) Këshilli rinor në komunën e Kërçovës	% e aktiviteteve rinore në zonat rurale # i iniciativave të bashkësive	Bashkësi dhe familje më të shëndetshme Përfshirje sociale e rritur	
Organizimi i trajnimeve për zyrtarët e policisë lokale, mësuesit dhe punonjësit socialë	Në vazhdimësi	EVK-të Komuna e Kërçovës	OJQ-të lokale KKPEDhLKT Donatorë	# i trajnimeve të organizuar	Kapacitete të rritura të zyrtarëve të policisë, mësuesve dhe punonjësve socialë	

në nivel lokal për identifikimin e rasteve të mundshme dhe parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm				% e zyrtarëve të policisë dhe punëtorëve socialë të trajnuar # i rasteve që kanë të bëjnë me ekstremizmin e dhunshëm	Zvogëlim i rasteve potenciale të ekstremizmit të dhunshëm	
Përpilimi dhe finalizimi i të gjitha dokumenteve të nevojshme ligjore dhe dokumenteve tjera për performancë më të mirë të EVK-ve në nivel lokal (rolet dhe përgjegjësitë, fushëveprimi dhe bashkëpunimi, etika dhe besueshmëria, procedurat e përzgjedhjes etj)	Çdo vit	EVK-të Komuna e Kërçovës	KKPEDhLKT Donatorë	# i udhëzimeve administrative të përpiluara dhe të miratuara	Rritje e qëndrueshmërisë, përgjegjësisë dhe pjesëmarrjes aktive të EVK-ve në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm	

